



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

***Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,  
Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry Entrepreneurship and Trade***

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë  
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu  
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

---

**Thirrje publike për aplikim në stendën shtetërore të Kosovës në panairin  
IF Wedding Fashion Izmir Fair 2026**

20-22 janar 2026  
Adresa: Izmir, Turqi

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare dhe gjetjes së tregjeve të reja ndërkombëtare për eksport të produkteve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset nga sektori i tekstilit, shtëpitë e modës dhe apo dizajnerët të aplikojnë përmes kësaj thirrjeje për të qenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtar. Në kuadër të këtij panairi, KIESA ka arritur të sigurojë një hapësirë ekspozuese prej 525 m<sup>2</sup>. KIESA do të mbulojë shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës dhe regjistrimin e deri në 8 biznese pjesëmarrëse. Ndërkaq, shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, shpenzimet tjera si dhe dërgimit të materialeve promovuese do të mbulohen nga vetë bizneset pjesëmarrëse. Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 28.12.2025. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;

7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës (kërkohet: gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 8 subjekte:

**Kriteret e vlerësimit:**

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
  - 1 pikë për 1 produkt
  - 3 pikë për 2 produkte
  - 5 pikë për 3 produkte
  - 7 pikë për 4 produkte dhe
  - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 5 pikë
  - Gjuhë Turke 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 4 pikë
  - Gjuhë Turke 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë vitit 2024/25, maksimum 10 pikë:
  - Shtetet e BE-së 5 pikë
  - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
  - Shtetet tjera 2 pikë.
- Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:
  - ISO 3 pikë dhe
  - Certifikime tjera 2 pikë.

- Paraqitja e subjektit aplikues në panaire apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
  - 1 deri në 3 panaire 3 pikë dhe
  - 4 deri në 6 panaire 5 pikë.
  
- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2024, maksimumi 10 pikë:
  - 0 - 500.000 euro 4 pikë
  - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
  - > 1,000.000 euro 10 pikë.

Më 17.12.2025, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 28.12.2025 në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetëtori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit: [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe [kiesa.rks-gov.net](http://kiesa.rks-gov.net) apo në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)